



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### Departamenti i Prokurimit

Data: 17.10.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.10.2022 të parashtruar nga **OE AI – Group Sh.P.K nga Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Hartimi i projekteve detale 3 llote me nr. të Prokurimit 613-22-10640-2-1-1**

### V E N D I M

**I Aprovohet si pjeserisht e bazaur,** kërkesa për ri-shqyrtim **OE AI – Group Sh.P.K nga Prishtinë**, të dt.12.10.2022 lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Hartimi i projekteve detale 3 llote me nr. të Prokurimit 613-22-10640-2-1-1**

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të Ndryshoj disa nga kërkesat e parashtruara tek kërkesa për Kapacitet teknik dhe profesional dhe tek vlera e parashikuar duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtim të **OE AI – Group Sh.P.K nga Prishtinë**,
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të dërgohet OE ankues në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## Arsyetim

**OE AI – Group Sh.P.K nga Prishtinë**, ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Hartimi i projekteve detale 3 llote” me nr. të Prokurimit 613-22-10640-2-1-1**

### **Pretendimi juaj i Parë.**

Pas analizimit të dosjes së tenderit në kërkesat e parashtruara nga ana juaj në piken 5.5 vlera e parashikuar keni bërë ndarjen e vlerës për 3 llote Llot 1 = 100.000.00 euro Llot 2 = 250.000.00 euro Llot 3 = 150.000.00 euro ku ne pergjithesi vlera i bie te jete 500 000.00 ndersa ne platformen E-prokurimi keni ofruar vleren 600.000.00 kerkojm sqarim nga ana juaj per per këtë pikë me çfarë matematike e keni bërë llogarin.

### **Pergjigje per pretendimin tuaj te parë**

Vlera e parashikuar per kete projekt eshte 500.000.00 euro.

**Ky pretenim i juaji eshte i Bazuar.**

### **Pretendimi juaj i Dytë.**

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 pika. h) Nje Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi infrastruktur rrugore, sistemi 5 vjeçar ose master (min. 6 vjet provojë pune nga diplomimi. Sa i perket kësaj kerese në vendin tonë ekzistojnë për afërsisht 4 inxhiniera të infrastrukturës rrugore me 6 vite përvojë pune kjo kërkesë e bënë të kufizuar numrin e OE për pjesëmarrje në këtë procedurë tenderimi, duke ju referuar kësaj pike keni cek ingjnier ose master ju lutemi na sqaroni se qka mund të jetë kërkesa ose master.

### **Pergjigje per pretendimin tuaj te dytë**

Duhet te ju njoftojme qe kerkesat e parashtruara per kete projekt jane bazuar ne rendesine e ketij projekti, ne kete projekt nevojiten staf me pervoj pune te mjaftueshme sepse ka pergjegjesi per projektet qe do te realizohen nga kompania fituese qe do kryej keto projekte.

**Ky pretenim i juaji eshte pjeserisht i Bazuar.**

**Sqarim:** *Ndryshimet do te paraqiten tek kjo procedure dhe do te shtyhet afati i hapjes sipas ligjeve te LPP-se*


AK ka zbatuar me përpikëri rregullat e nxjerra nga KRPP

Drejtori i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Bekim Shabani



Drejtör i Prokurimit